



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



Komisioneri për Mbrojtjen
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection
from Discrimination

Nr. 675 Prot.
Datë 27.04.2022



Nr. 974/1 Prot
Datë 14.04.2022

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

NDËRMJET

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

« Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017 « Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti »

Sot, më datë 27.04.2021 lidhet kjo Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet Palëve :

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me adresë: Rruga e Durrësit Nr.27, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Robert Gajda**, këtu e në vijim « *Komisioneri* ».

Dhe

Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, me adresë: Rruga « Jordan Misja », Godina nr. 3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas **Z. Ergys Qirici**, këtu e në vijim « *Drejtoria* ».

Duke qënë se Palët,

Vlerësojnë rëndësinë e sistemit të ndihmës Juridike të garantuar nga shteti në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët si një parim themelor kushtetues.

Konsiderojnë se një ndër elementët kyç të aksesit në drejtësi është sigurimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë marrëveshje mirëkuptimi në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje mes Palëve konsiston në vendosjen e bashkëpunimit sa i përket shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim ndërmarrjen e masave për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve dhe në veçanti të personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, kategori e drejtëpërdrejtë përfituese e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje mirëkuptimi bazohet në nenin 8 shkronja “e” të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Neni 3

Qëllimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë mbi:

- Promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- Shkëmbimin e përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- Kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.
- Referim i rasteve për të përfituar ndihmë juridike parësore falas pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

Neni 4

Personat e kontaktit

Secila nga palët cakton një person kontakti të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje personat e kontaktit janë si vijon :

Për Komisionerin

-
-
-
-

Për Drejtorinë:

- Patricia Pogaçe
- Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
- Cel: +355 68 258 3445
- E-mail: patricia.pogace@drejtesia.gov.al

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 6

Dispozita të fundit

Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve.

Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeve pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR KOMISIONERIN PËR
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Z. Robert Gajda
Komisioneri për mbrojtjen nga
Diskriminimi



**PËR DREJTORINË E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

Z. Ergys Qirici
Drejtore i Përgjithshëm

